



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 88

Prishtinë, më 28.12.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Agim Ademaj, Armend Zemaj, Valdete Bajrami, Agim Aliu, dhe Pal Lekaj.

Munguan: Doruntinë Maloku dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Mejreme Tahirukaj-Radio Kosova, Pranvera Dobruna-praktikante, Naim Hajdari-EULEX, Granit Berisha-praktikant, Egzon Pacolli-praktikant, Eugen Cakolli-KDI, Agnesa Haxhiu-KDI dhe Dren Ajeti-GSJP.

Stafi mbështetës i Komisionit; Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 21.11.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit i Grupit Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-03, dhe ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-035;
4. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Institucioneve/Agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion;

5. Intervistimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
6. Të ndryshme.

Pas diskutimeve komisioni vendosi që pika 3 të hiqet nga rendi i ditës, ndërsa në rend dite hyri Raporti për Akademinë e Drejtësisë me propozim të deputetit Agim Aliu.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja- Propozoj që raporti të hiqet nga rendi i ditës ngase është shumë i përgjithësuar dhe se ky raport duhet të jetë më konkret, sidomos në pjesën e rekomandimeve.

Ky propozim u përkrah nga anëtarët tjerë të komisionit, dhe u dakorduan që pika 3 të hiqet nga rendi i ditës dhe të shqyrtohet në një nga mbledhjet e radhës.

Agim Aliu- Propozoj që në Projektligjin për Akademinë e Drejtësisë të hiqet amendamenti 37, për shkak se ky amendament ka humbur logjikën për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar gjatë procesit të amendamentimit dhe mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës natyrshëm do të përfundojë këtë vit.

Me këtë propozim u pajtuan të gjithë anëtarët e komisionit dhe u dakorduan që ky amendament të hiqet nga Projektligji për Akademinë e Drejtësisë.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 21.11.2016;

Kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 21.11.2016 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Institucioneve/Agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion;

Armend Zemaj- Grupi punues i ka shqyrtuar kërkesat buxhetore të Institucioneve- Agjencive të cilat bien në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion dhe shumica e këtyre kërkesave nuk kanë arsyetim të plotë. Por, meqenëse Projektligji për Buxhetin ka kaluar me procedura të përshpejtuara, dhe duke pasur parasysh faktin se të njëjtat nuk kanë mundur të miratohen në komision, si kryesues i grupit kam paraqitur si amendamente personale me qëllim që të njëjtat të procedohen në Komision për Buxhet dhe në seancën plenare.

Albulena Haxhiu, kryetare- Është mirë që Komisioni për Legjislacion bën shqyrtimin e kërkesave buxhetore të Institucioneve-Agjencive, të cilat bien në fushëveprim të komisionit, por është shqetësuese që asnjëherë nuk po shtyhen përpara këto kërkesa, kur dihet se buxheti çdoherë po kalon me procedurë të shpejtë. Roli i Komisionit për Legjislacion në gjashtëmujorin e ardhshëm do të jetë më i fuqishëm në përkrahje të institucioneve të drejtësisë sepse po të mos ketë përkrahje, ky sistem me përballje të mungesës së buxhetit do të jetë joefikas në punën që bën.

4. Intervistimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;

Kryetarja njoftoi të pranishmit për përgatitjet e bëra para fillimit të intervistimit. Ajo, tha se tashmë kemi praktikë sesi t'i bëjmë intervistimet e tilla, ku secili kandidat do të ketë 10 minuta në dispozicion për përgjigje. Po ashtu, anëtarët e komisionit u pajtuan që pyetjet të bëhen nga kryetarja e komisionit Albulena Haxhiu. Pyetjet do të jenë të njëjta, për secilin kandidat, kurse për prezencën e shoqërisë civile, u vendos që ata mund të qëndrojnë gjatë intervistimit.

- Pyetja nga kryetarja e Komisionit, Albulena Haxhiu, ishte: Si e vlerësoni punën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, cili është vizioni juaj për të cilin keni aplikuar në këtë pozitë? A jeni në dijeni me përbërjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës?
- Pyetja e parashtruar nga deputetja Haxhiu për kandidatët serbë ishte: a i njihni institucionet e Republikës së Kosovës dhe cili është vizioni juaj për Këshillin Gjyqësor të Kosovës?
- Pyetja nga deputeti Pal Lekaj ishte: Në çka e mbështetni kandidimin tuaj për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës?
-

Komisioni, pas shqyrtimit të të gjitha çështjeve që kishin të bënin me përgatitjet e intervistimit të kandidatëve, vlerësoi se janë bërë të gjitha përgatitjet për t'ia filluar punës.

Intervistimi i kandidatëve filloi në orën 11:30. Për intervistë ishin ftuar shtatë kandidatë, kandidatët u intervistuan në bazë të listës si vijon:

1. Shadije Gerguri
2. Qerim Fazliji
3. Ahmet Imami
4. Ivica Ivanoviç
5. Radojka Trifunoviç
6. Radica Berishaj
7. Osman Cucoviç.

Së pari u intervistua kandidatja Shadije Gërguri dhe intervistimi vazhdoi sipas radhës. Për kandidatin Ahmet Imami, Komisioni vendosi që të mos intervistohet sepse nuk kishte plotësuar kriteret e parashtruara sipas konkursit. Ndërsa në intervistë nuk erdhi kandidatja Radica Berishaj.

Komisioni, pas përfundimit të intervistimit të kandidatëve dhe duke u bazuar në vlerësimin e anëtarëve të Komisionit, në poentimin e secilit kandidat, rezultoi se kandidatja Shadije Gërguri arriti 70 pikë, Qerim Fazliji - 63 pikë, Radojka Trifunoviç - 68 pikë dhe Ivica Ivanoviç - 50 pikë.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në bazë të nenit 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 dhe 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 5 A të Ligjit nr. 05/L - 033, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Republikës Kosovës, vendosi, që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohen Kuvendit për votim të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të renditur sipas rezultateve të poentimit:

I. Për pozitën e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komunitetit serb, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, propozohen:

1. Radojka Trifunoviq - 68 pikë, dhe
2. Ivica Ivanoviq - 50 pikë.

II. Për pozitën e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nga radhët e komuniteteve tjera, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, propozohen:

1. Shadije Gërguri- 70 pikë, dhe
2. Qerim Fazliji - 63 pikë.

III. Kuvendi, prej 2 (dy) kandidatëve të propozuar për anëtar të Këshillit Gjyqësor, do të zgjedhë një kandidat.

IV. Votimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor, bëhet me votim të fshehtë.

V. Mandati i anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është 5 (pesë) vjet.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu